



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR



Nr. 204 Regjistri Themeltar

Data e regjistrimit 20.01.2020

Nr. 1463 Vendimi

Data 23.01.2020

VENDIM

PËR RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Në Tiranë sot më datën 23.01.2020, unë **Julian HAXHIU** gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kerkuesit **Lude Taqe** për regjistrimin e personit juridik të **Qendrës “Youthful”**, shkurt **“UTHFUL”**,

KONSTATOVA

Se kërkuesi kërkon të regjistrojë si person juridik qendrën **“Youthful”** me seli në adresën: Rruga “Budi/ Petraq Xhacka”. Nr.8, Tiranë, Shqipëri.

Qëllimi i qendrës “Youthful” është fuqizimi i rinisë si promotori kryesor i zhvillimit të vendit. Synojnë të kontribuojnë në përforcimin e rolit aktiv të qytetareve dhe sidomos të të rinjve duke i afruar me vlerat qytetare dhe demokratike. Me anë të projekteve ne do të kontribuojë në fuqizimin e të rinjve në çdo rajon të Shqipërisë, në marrjen e një roli aktiv për jetën e tyre, familjen, shoqërinë, arsimin, ekonominë, mjedisin. Fusha e veprimtarisë është zhvillim projektesh, në funksion të përmirësimit të treguesve të zhvillimit rinor. Organizata do të mbështesë zhvillimin e aktiviteteve në të mirë dhe interes të publikut, duke përfshirë çështje të tilla si: zhvillimin e karrieres, të drejtat e njeriut, demokracinë/qytetaria aktive, si dhe përmirësimin e treguesve të zhvillimit social-ekonomik. Gjithashtu, ajo do të ofrojë konsulencë, studime, botime, anketime, konferenca, seminare, trajnime, fushata sensibilizuese dhe mbështetëse në fushën e arsimit, kultures, turizmit, ekonomisë, mjedisit e të tjera. Kjo qendër për arritjen e qëllimit për të cilin është krijuar ushtron edhe veprimtari të tjera, me kusht që ato të mos vijnë në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

“Youthful” organizon aktivitete në përputhje me këtë Statut dhe ligjet në fuqi, duke mos u kufizuar vetëm në to, si:

1. Konferenca, kërkime shkencore dhe analiza studimore.
2. Tryeza të rrumbullakta, seminare, trajnime në fusha të ndryshme.
3. Misionë monitorimi, deklarata shtypi, reagime publike dhe peticione.



4. *Aktivitete sensibilizuese dhe informuese.*

Selia e Qendrës “Youthful” do të jete në adresën: Rruga “Budi/ Petraq Xhacka”. Nr.8, Tiranë, Shqipëri.

Qendra “Youthful” do t’a ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

Organet drejtuese te Qendrës “Youthful” janë:

- **Bordi Drejtues, si organ vendimmarrës;**
- **Drejtori Ekzekutiv si organ administrativ dhe ekzekutiv.**

Qendra “Youthful” themelohet nga 4 Persona Fizikë.

Themeluesit e “Youthful” janë si më poshtë:

1. *Lude Taqe, e bija e Bujarit, lindur në Konispol, Sarande, me datelindje 14.06.1995 dhe banuese në Tiranë, e pajisur me leternjoftim ID me Numër Personal: J55614054S,*
2. *Igli Ali, i biri i Arbenit, lindur ne Konispol, Sarande, me datelindje 20.10.1995 dhe banues ne Tiranë, i pajisur me leternjoftim ID me Numër Personal: J51020064G,*
3. *Klea Sholla , e bija e Lorencit, lindur në Berat, me datelindje 12.10.1995 dhe banuese ne Tirane, e pajisur me leternjoftim ID me Numer Personal: J56012070U,*
4. *Gildijan Mulla i biri i Guximit, lindur ne Konispol, Sarande, me datelindje 01.10.1998 dhe banuese ne Tirane, e pajisur me leternjoftim ID me Numer Personal: J81001055H,*

Anetarët e parë te Bordit te Drejtorve janë: *Lude Taqe, Igli Ali, Gildijan Mulla, Klea Sholla. Drejtor Ekzekutiv dhe perfaqesues ligjor është znj. Lude Taqe.*

Kryetar i Bordit te Drejtorve është Z. Igli Ali.

Kërkesa është gjetur e bazuar në ligj dhe ne prova si edhe në statutin e qendrës, dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit 8789 datë 07.05.2001 “ Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” të ndryshuar dhe ligjin nr 8789 datë 07.05.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, të ndryshuar.

VENDOSA :

Pranimin e kërkesës



Regjistrimin si person juridik të Qendrës “Youthful” si organizatë joqeveritare, jofitimprurëse pa anëtarësi, me afat të papërcaktuar kohor.

Selia e Qendrës “Youthful” do të jetë në adresën : Rruga “Budi/ Petraq Xhacka”. Nr.8, Tiranë, Shqipëri.

Qendra “LEGAL AND SOCIAL STUDIES CENTER” (LSSC) do t’a ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

Organet drejtuese te Qendrës “Youthful” janë:

- **Bordi Drejtues, si organ vendimmarrës;**
- **Drejtori Ekzekutiv si organ administrativ dhe ekzekutiv.**

Themeluesit e qendres “Youthful” janë: *Lude Taqe, Igli Ali, Klea Sholla, Gildijan Mulla.*

Anetarët e parë te Bordit te Drejtorve janë: *Lude Taqe, Igli Ali, Gildijan Mulla, Klea Sholla. Drejtor Ekzekutiv dhe perfaqesues ligjor është znj. Lude Taqe.*

Kryetar i Bordit te Drejtorve është Z. Igli Ali.

Urdhërimin e zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse të bëjë shënimet përkatëse në skedën e kësaj OJF-je .

Datë 23.01.2020.



GJYQTAR

Julian HAXHIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 266 Regj Them
Data e Regjistrimit 03.02.2020

Nr. 1463/1Vendimi
Date 10.02.2020



“PER NDREQJE GABIMI”

Sot ne Tirane me date 10.02.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e përbërë nga:

Gjyqtar : Julian HAXHIU

Me cilësinë e gjyqtarit të vetëm në dhomë këshillimi mora në shqyrtim çështjen civile me Nr. 266 Akti që i përket

KERKUES

Lude Taqe me adrese Tirane, Rruga Reshit Collaku hyrja 18, kati 2, ap.262.

OBJEKTI

Ndreqja e gabimeve te Vendimit Nr. 1463 datë 23.01.2020 të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, konkretisht te emrit të organizatës nga Qendra "LEGAL AND SOCIAL STUDIES CENTER" (LSS) ne sakesimin e emrit si qendra "YOUTHFUL" UTHFUL.

BAZA LIGJORE

Ligji nr. 7850, date 29.07.1994 “KC i RSH, neni 312 K.Pr.Civile

Gjykata, pasi mori në shqyrtim pa praninë e pales kerkuese kërkesen objekt gjykimi, duke iu referuar përmbajtjes së saj dhe provave shkresore bashkangjitur,

VËREN

Kërkuesi ka paraqitur një kerkese duke kërkuar ndreqjen e gabimeve te Vendimit Nr. 1463 datë 23.01.2020 të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, konkretisht te emrit të organizatës nga Qendra "LEGAL AND SOCIAL STUDIES CENTER" (LSS) ne sakesimin e emrit si qendra "YOUTHFUL" UTHFUL.

Me anë të Vendimit Nr. 1463 datë 23.01.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë ka vendosur pranimin e kerkeses konkretisht:

Pranimin e kërkesës

Regjistrimin si person juridik të Qendrës “Youthful” si organizatë joqeveritare, jofitimprurëse pa anëtarësi, me afat të papërcaktuar kohor.

Selia e Qendrës “Youthful” do të jetë në adresën : Rruga “Budi/ Petraq Xhacka”. Nr.8, Tiranë, Shqipëri.

Qendra “LEGAL AND SOCIAL STUDIES CENTER” (LSSC) do t’a ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.

Organet drejtuese te Qendrës “Youthful” janë:

- *Bordi Drejtues, si organ vendimmarrës;*
- *Drejtori Ekzekutiv si organ administrativ dhe ekzekutiv.*

Themeluesit e qendres “Youthful” janë: Lude Taqe, Igli Ali, Klea Sholla, Gildijan Mulla.

Anetarët e parë te Bordit te Drejtorve janë: Lude Taqe, Igli Ali, Gildijan Mulla, Klea Sholla. Drejtor Ekzekutiv dhe perfaqesues ligjor është znj. Lude Taqe.

Kryetar i Bordit te Drejtorve është Z. Igli Ali.

Urdhërimin e zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse të bëjë shënimet përkatëse në skedën e kësaj OJF-je .

Mirepo pala kërkuese në vendimin e shpallur nga gjykata ka konstatuar një pasaktësi të dukshme konkretisht në pjesën e dispozitivit të vendimit ne lidhje me emrin e ketij personi juridik.

Ndërkohë që pala kërkuese ka pretenduar se duhej të shkuhej:

..... Qendra "YOUTHFUL" UTHFUL.....

Neni 312 i Kodit te Procedures Civile parashikon se :

“Pas shpalljes së vendimit gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit.

Gjykata, pasi thërret palët, në seancë, e shqyrton kërkesën sipas rregullave të këtij Kodi, jep vendim, i cili i bashkohet vendimit të ndrequr. Kundër vendimit të dhënë për rastet e parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit”.





Nga analiza vendimit te mesiperm gjyqesor, nga faktet reale gjykates i krijohet bindja ligjore se ne pjesen e dispozitivit te vendimit duhet të saktësohet dhe të përcaktohet përfundimisht emri i qendres:

..... *Qendra "YOUTHFUL" UTHFUL*.....

Keto pasaktësi duhet të rregullohen me anë të ndreqjes në të gjitha pjesët e këtij vendimi. Duke arsyetuar sa me siper kjo gjykate arrin ne konkluzionin se Vendimi Nr. 1463 datë 23.01.2020 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tiranë duhet të ndreqet në menyrë që të rregullohet kjo pasaktësi.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 312 te Kodit te Procedures Civile, Gjykata.

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës.
- Ndreqjen e gabimeve në Vendimit Nr. 1463 datë 23.01.2020 të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë duke e ndrequr emrin e qendres dhe duke e lënë përfundimisht si më poshtë :

..... *Qendra "YOUTHFUL" UTHFUL*.....

- Ky vendim do ti bashkohet Vendimit Nr. 1463 datë 23.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tirane, sot më datë 10.02.2020.

Vendimi mori forme te prare pasi
nuk u ankimua me dt 24.02 2020
Tirane me dt 28.02 2020



Gjyqtar

Julian HAXHIU